



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 23 dhjetor 2024  
Nr. Ref.:AGJ 2592/24

## **AKTGJYKIM**

në

**rastin KI118/23**

Parashtrues

**Shehide Muhadri**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Ac. nr. 530/2016 të 30 marsit 2023  
të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Bajram Ljatifi, gjyqtar  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Shehide Muhadri nga komuna e Lipjanit (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson Sabri Kryeziu, avokat nga Lipjani.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Ac. nr. 530/2016] të 30 marsit 2023 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës, më 4 maj 2023.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Ac. nr. 530/2016] të 30 marsit 2023 të Gjykatës së Apelit, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

7. Më 6 qershor 2023, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 8 qershor 2023, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin [GJR. KI118/23] caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe me Vendimin [KSH. KI118/23] caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
9. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
10. Më 5 nëntor 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën datë, Gjykata pas këshillimit dhe votimit konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar është në përputhshmëri me dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës, si dhe me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

## **Përmbledhja e fakteve të rastit**

*Kërkesa e parë KI145/20*

11. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës parashtron për herë të tretë kërkesë në Gjykatë. Kërkesën e parë [KI145/18], parashtruesja e kërkesës e parashtrroi së bashku me M.M. dhe S.I, nëpërmjet të cilës kontestuan kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Ac. nr. 530/2016] të 18 qershorit 2018, të Gjykatës së Apelit. Në këtë rast, më 19 korrik 2018 Gjykata kishte konstatuar shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së, për shkak të mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor, në lidhje me mos adresimin e pretendimit për shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës nga ana e Gjykatës së Apelit. Si rezultat, më 10 dhjetor 2019, Gjykata e Apelit në riprocedurë dhe në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI145/18, nxori Aktgjykimin [Ac. nr. 530/2016], me të cilin (i) refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtrueses së kërkesës, dhe (ii) vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 19/2015] e 11 nëntorit 2015 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - dega në Lipjan - Departamenti i Përgjithshëm.

*Kërkesa e dytë KI49/20*

12. Parashtruesja e kërkesës ndaj Aktgjykimi [Ac. nr. 530/2016], të 10 dhjetorit 2019 të Gjykatës së Apelit, kishte parashtruar kërkesën e dytë KI49/20, nëpërmjet së cilës kontestoi kushtetutshmërinë e aktgjykimit të lartcekur. Gjykata përkitazi me kërkesën e dytë KI49/20, vendosi më 20 janar 2022 dhe konstatoi përsëri shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së, për shkak se Aktgjykimi i 10 dhjetorit 2019 i Gjykatës së Apelit, nuk përmbushte standardin që i garanton individit/ëve "një gjykim të drejtë" në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafi të 1 nenit 6 të KEDNj-së, përkatësisht të drejtën për një vendim të arsytuar dhe të arsyeshëm gjyqësor.

*Kërkesa e tretë (aktuale) KI183/23*

13. Më 30 mars 2023, Gjykata e Apelit, në riprocedurë dhe duke marrë parasysh Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI49/20, nxori Aktgjykim të ri [Ac. nr. 530/2016], nëpërmjet të cilit (i) refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe (ii) konfirmoi Aktgjykimin [C. nr. 19/2015] e 11 nëntorit 2015 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - dega në Lipjan.
14. Në pjesën arsytuese të Aktgjykimit, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, theksoi: "Nga të cekurat më lart, Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për faktin se nuk është gjetur se ekzistojnë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë si dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale. Gjykata e Apelit vlerëson se deri më tani, jo vetëm për rastin e paditësve por edhe për rastet tjera kur kërkohet pronësia me parashkrim fitues në pronën shoqërore, është qëndrimi i shprehur në vendimet e Gjykatës Supreme se në pronën shoqërore nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë me parashkrim fitues.
15. Më 12 maj 2023, parashtruesja e kërkesës i propozoi Prokurorisë së Shtetit që ete ngrëntë në Gjykatën Supreme "kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë", kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 530/2016], të 30 marsit 2023 të Gjykatës së Apelit, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
16. Më 29 maj 2023, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, nëpërmjet Njoftimin KMLC. nr. 60/23, njoftoi parashtruesen e kërkesës se nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme ligjore për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

## Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

17. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi i ri [Ac. nr. 530/2016] i 30 marsit 2023 i Gjykatës së Apelit, shkel të drejtat e saj të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
18. Parashtruesja e kërkesës saktësisht pretendon: *“Me këtë vendosje të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë është shkelur Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe atë e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga neni 31.1 dhe barazia para ligjit nga neni 24 të Kushtetutës dhe neni 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe neni 2 par. 1 pika a) i Ligjit Kundër Diskriminimit, sepse paditësit janë me përkatësi ashkalinjë - pakicë, ndërsa nga e njëjta (identike) bazë juridike - si refugjatë të Republikës së Shqipërisë, në të njëjtën kohë iu është dhënë në shfrytëzim paluajtshmëria (shtëpia dhe tokë) dhe nga e njëjta gjykatë iu është njohur e drejta e pronësisë familjes F.I. nga fshati Babush i Muhaxherëve, nga e njëjta bazë dhe nga e njëjta gjykatë iu është njohur e drejta e pronësisë familjes E.M., A.M., A.M., A.M. dhe F.D., që të gjithë nga fsh. Bregu i Zi K. Lipjan, nga e njëjta bazë dhe e njëjta gjykatë iu është njohur e drejta e pronësisë edhe familjes Bresa nga Gracka e Vogël K. Lipjan, dhe nga baza identike për nga gjendja faktike dhe juridike, me vendim të plotfuqishëm i është njohur e drejta e pronësisë edhe paditëses Xh.H., nga fsh. Babush i Muhaxherëve, të cilat aktgjykime i janë bashkangjitur kërkesës së mëhershme të dërguar në Gjykatën Kushtetuese (rasti nr. KI145/18 nr. Ref. AGJ1408/14 Prishtinë më 13 gusht 2019) dhe rastit KI49/20 nr. ref. AGJ 1962/22 Prishtinë 17 mars 2022). [...]”.*
19. Parashtruesja e kërkesës pretendon se në Aktgjykimin e ri, Gjykata e Apelit ka bërë një vlerësim të gabuar. Më konkretisht, ajo pohon se Gjykata Kushtetuese ka analizuar se Gjykata e Apelit, në vendimet e saj të mëparshme ua ka njohur paditësve tjerë të drejtën e pronësisë, në raste identikë për nga rrethanat faktike dhe juridike, ndërsa në rastin e saj ka vendosur ndryshe nga praktika gjyqësore.
20. Duke pretenduar shkelje në aktgjykimin e ri të Gjykatës së Apelit, parashtruesja e kërkesës potencon se: *“Gjykata e Apelit nuk ka arritur t’i evitojë shkeljet e konstatuara nga Gjykata Kushtetuese, dhe prapë se prapë ka nxjerrë vendim refuzues në këtë çështje, duke vepruar prapë se prapë në kundërshtim me vërejtjet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese, dhe duke përsëritur shkeljet e konstatuara [...]. Gjykata e Apelit gabimisht vlerëson se vendimet e mëparshme nuk përbëjnë praktikë gjyqësore vetëm me faktin se nuk ka vendosur edhe Gjykata Supreme, e që një vlerësim i tillë është i gabuar për faktin se ato vendime janë të plotfuqishme, dhe vendimi i plotfuqishëm paraqet praktikë gjyqësore pavarësisht se cila instancë gjyqësore e ka nxjerrë atë, dhe pavarësisht nëse ligjshmëria e atyre vendimeve është apo nuk është vlerësuar nga Gjykata Supreme”.*

## Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

### KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

#### Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër*

personal. 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato”.

### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

## **KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

### **Neni 6**

#### **E drejta për një proces të rregullt**

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht”.

**LIGJI MBI MARRËDHËNIET THEMELORE JURIDIKE PRONËSORE** (në zbatim prej 8 shkurtit 1980, deri më 26 qershor 1996)

### **Neni 20**

*E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim.*

*E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj.*

### **Neni 28**

*Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej tre vjetësh.*

*Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.*

*Mbajtësi me mirëbesim i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.*

*Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh. Trashëgimtari bëhet mbajtës me mirëbesim nga*

*momenti i hapjes së trashëgimisë edhe në rastin kur trashëgimlënësi ka genë mbajtës me keqbesim, e trashëgimtari këtë nuk e ka ditur as që ka mundur ta dinte kurse koha për parashkrimin fitues fillon të ecë nga momenti i hapjes së trashëgimisë.*

**Neni 29**  
**[I fshirë]**

**Neni 33**

*Në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj".*

**Pranueshmëria e kërkesës**

21. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

*[...]*

23. Gjykata, gjithashtu, shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet: 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që përcaktojnë:

**Neni 47**  
**(Kërkesa individuale)**

*"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

**Neni 48**  
**(Saktësimi i kërkesës)**

*"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

**Neni 49**  
**(Afati)**

*"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]"*

24. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se: (i) parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës; (ii) e njëjta konteston Aktgjykimin [Ac. nr. 530/2016] e 30 marsit 2023 të Gjykatës së Apelit. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ka saktësuar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur nga Gjykata e Apelit, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në përputhje me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
25. Përveç kriterëve të lartcekura, Gjykata shqyrton gjithashtu nëse parashtruesi/ja i/e i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafët (1) dhe (2) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

Rregulli 34  
(Kriteret e pranueshmërisë)

*“(1) Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:*

*[...]*

*(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.*

*(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.*

26. Gjykata bazuar në rrethanat e rastit konkret konsideron se kërkesa nuk mund të konsiderohet qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç parashihet me paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, dhe për pasojë, kërkesa mund të shpallet e pranueshme për shqyrtim në merita (shih, gjithashtu rastin e GjEDNj-së, [Alimuçaj kundër Shqipërisë](#), nr. 20134/05, Aktgjykim i 9 korrikut 2012, paragrafi 144, si dhe rastet e Gjykatës [KI75/21](#), parashtrues “*Abrazen LLC*”, “*EnergyDevelopmentGroup Kosova LLC*”, “*Als&Co. Kosovë LLC*” dhe “*BuildingConstruction LLC*”, Aktgjykim i 19 janarit 2022, paragrafi 64; [KI27/20](#), parashtrues, *Lëvizja VETËVENDOSJE!*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafi 43, dhe së fundmi [KI82/22](#), parashtrues *Valon Loxhaj*, Aktgjykimi i 7 qershorit 2023, paragrafi 59).
27. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtrueses së kërkesës përmbush kriteret për vlerësim në merita.

### **Meritat e kërkesës**

28. Gjykata rikujton se kërkesa e tanishme KI118/23 e parashtrueses së kërkesës, ka të bëjë me pretendimin e përsëritur se Gjykata e Apelit nuk mori parasysh gjetjet e Gjykatës Kushtetuese në rastin KI49/20, të shprehura nëpërmjet Aktgjykimit të saj të 20 janarit 2022, për t’i evituar dhe mënjeluar shkeljet e të drejtave të saj të garantuara me Kushtetutë.
29. Nisur nga natyra që ngërthen kërkesa e tanishme, gjegjësisht nga esenca e ankesës kushtetuese, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtrueses së kërkesës duhet të vlerësohen në kuadër të së drejtës për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së, për faktin se aktgjykimet e mëparshme të Gjykatës së Apelit janë shpallur të pavlefshëm pikërisht mbi këtë bazë.

30. Në kontekst të vlerësimit të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

**A. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së.**

*i) Parimet e përgjithshme*

31. Garancitë e mishëruara në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së, përfshijnë edhe detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsyetim të mjaftueshëm për vendimet e tyre. (shih, rastin e GjEDNj-së, [H. kundër Belgjikës](#), nr. 8950/80, Aktgjykim i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53). Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë. Përkundër faktit që gjykatat kanë një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmërinë e dëshmimeve, ato janë të detyruara të justifikojnë veprimet e tyre, duke arsyetuar të gjitha vendimet e tyre (shih rastet e GjEDNj-së: [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 36; si dhe rastin [Carmel Saliba kundër Maltës](#), nr. 24221/13, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73).
32. Gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, nga ana tjetër duhet të japin arsye dhe arsyetime të tilla të cilat do t'u mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih rastin e GjEDNj-së [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. 49684/99, i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30). Pra, praktika gjyqësore e GjEDNj-së thekson se funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë (shih *mutatis mutandis*, rastin e GjEDNj-së [Hirvisaari kundër Finlandës](#), cituar më lart, paragrafi 30, [Tatishvili kundër Rusisë](#), nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58 dhe [Suominen kundër Finlandës](#), cituar më lart, paragrafi 37).
33. Neni 6 i KEDNj-së, nëpërmjet paragrafit 1 të tij i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih rastet e GjEDNj-së, [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 29 janarit 1999, paragrafi 26; [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81). Nga natyra e vendimit që merr gjykata varet nëse gjykata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë: është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtrësive që një palë mund t'ia paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë midis sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjyqimeve (shih rastet e GjEDNj-së [Ruiz Toria kundër Spanjës](#), nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27).
34. Megjithatë, nëse parashtrësia e një pale është vendimtare për rezultatin e procedurës, ajo kërkon që t'i përgjigjet në mënyrë specifike dhe pa vonesë (shih rastet e GjEDNj-së, [Ruiz Toria kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 30; Aktgjykimi [Hiro Balani kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 28). Prandaj, sipas praktikës së GjEDNj-së, gjykatat



nacionale janë të obliguara që: a) të shqyrtojnë argumentet kryesore të palëve (shih rastet [Buzescu kundër Rumanisë](#), nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 gushtit 2005, paragrafi 67; [Donadze kundër Gjeorgisë](#), nr. 74644/01, Aktgjykim i 7 qershorit 2006, paragrafi 35); b) të shqyrtohen me shumë rigorozitet dhe kujdes të veçantë kërkesat në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, KEDNj dhe protokollet e saj (shih rastet e GjEDNj-së: [Fabris kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafi 72; [Wagner dhe JMWL kundër Luksemburgut](#), nr. 76240/01, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96).

35. Në mënyrë të ngjashme, në një rast ku bëhet fjalë për një kërkesë që të lejohet parashtrimi i ankesës, që është një parakusht për procedurën te një gjykatë më e lartë, si dhe për një vendim të mundshëm, neni 6, paragrafi 1, nuk mund të interpretohet në atë kuptim që të urdhëron një arsyetim të detajuar të vendimit për refuzimin e kërkesës për parashtrimin e ankesës (shih rastet e GjEDNj-së, [Kukkonen kundër Finlandës](#) (nr. 2), nr. 47628/06, Aktgjykim i 13 prillit 2009,) paragrafi 24; [Bufferne kundër Francës](#), nr. 54367/00, Vendimi i 26 shkurtit 2002).
36. Përveç kësaj, kur refuzon një ankesë, Gjykata e Apelit, në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët (shih rastin e GjEDNj-së, [García Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 26; shih, në kundërshtim me këtë, [Tatishvili kundër Rosisë](#), nr. 1509/02, Aktgjykim i 9 korrikut 2007,) paragrafi 62). Megjithatë, koncepti i procedurës së drejtë nënkupton që gjykata vendase që ka dhënë një shpjegim të ngushtë për vendimet e saj, qoftë duke përsëritur arsyetimet e dhëna më parë nga një gjykatë më e ulët ose në ndonjë mënyrë tjetër, në fakt merrej me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, që do të thotë se nuk i pranoi thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih rastin [Helle kundër Finlandës](#), nr. (157/1996/776/977), Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60). Kjo kërkesë është aq më e rëndësishme nëse pala në kontest nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë argumentet e saj gojarisht në procedurën para gjykatës vendase.
37. Megjithatë, gjykatat e apelit (në shkallën e dytë) të cilat kanë juridiksion për të hedhur poshtë ankesat e pabazuara dhe për të zgjidhur çështjet faktike dhe juridike në procedurën kontestimore, janë të obliguara të arsyetojnë se përse refuzuan të vendosin për ankesën (shih, rastin e GjEDNj-së, [Hansen kundër Norvegjisë](#), nr. 15319/09, Aktgjykim i 2 janarit 2015, paragrafët 77–83).
38. Në fund, Gjykata gjithashtu i referohet praktikës së saj gjyqësore ku ajo konstaton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritave dhe reflektimeve kur të merren parasysh provat e propozuara nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre (Gjykata Kushtetuese, rastet: nr. [KI72/12](#), [Veton Berisha dhe Ilfete Haziri](#), Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; dhe nr. [KI135/14](#), [IKK Classic](#), Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58).

## **B. Vlerësimi i Gjykatës**

### *i) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret*

39. Gjykata rikujton se ajo tashmë në rastet [KI145/18](#) dhe [KI49/20](#) kishte vendosur dy herë për të njëjtat pretendime të parashtrueses së kërkesës, duke konstatuar shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë, për shkak se aktgjykimet e Gjykatës së Apelit nuk përmbushnin standardet e vendimit të arsyetuar dhe të arsyeshem gjyqësor. Andaj, duke pasur parasysh faktin që parashtruesja e kërkesës ngre pretendime të njëjta edhe ndaj Aktgjykimit të kontestuar [Ac. nr. 530/2016] të 30 marsit 2023 të Gjykatës së

Apelit, Gjykata do t'i referohet pjesëve relevante të këtij aktgjykimi dhe do të vlerësojë nëse janë mënjeluar shkeljet procedurale të konstatuara nga Gjykata, në rastin [KI49/20](#).

40. Gjykata rikujton se nëpërmjet Aktgjykimit [KI49/20](#), e njëjta kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së, duke u fokusuar në parimin e vendimit të paarsyetuar gjyqësor, për shkak se Gjykata e Apelit vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - dega në Lipjan [C. nr. 19/2015], të 11 nëntorit 2015, pa i adresuar fare pretendimet e parashtrueses së kërkesës. Gjykata në rastin [KI49/20](#) kishte konkluduar: *“Gjykata e Apelit në Aktgjykimin Ac. nr. 530/2016 sërish e shpërfilli tërësisht çështjen kryesore për të cilën është dashur të jepte një arsyetim, edhe pse ajo ishte specifike, relevante dhe e rëndësishme për parashtruesen e kërkesës. Në këto rrethana, mund të thuhet se një arsyetim i tillë, siç është përpiluar në Aktgjykimin e ri, para së gjithash nuk është në përputhje me gjetjet e Aktgjykimit KI145/18, dhe për këtë arsye si i tillë nuk është as në pajtim me detyrimet nga neni 6, paragrafi 1 i KEDNj-së në lidhje me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor.[...]”*
41. Nisur nga gjetjet e saj në rastin [KI49/20](#), Gjykata vëren se Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e kontestuar [Ac. nr. 530/2016] të 30 marsit 2023, ndër të tjera, arsyetoi: *“Kjo gjykatë, sqaron për palën paditëse se, nuk mund të konsiderohet devijim nga praktika gjyqësore vendimet e marrura nga gjykata e shkallës së parë, sepse gjykata e shkallës së parë në asnjë mënyrë nuk krijon praktikë gjyqësore, vendimet e gjykatës së shkallës së parë vlerësohen edhe nga dy instanca më të larta, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, në shkallë të parë çështja vendoset nga gjyqtari individual, ndërsa vendimi i saj vlerësohet nga kolegji prej tre gjyqtarëve në shkallë të dytë dhe Gjykatën Supreme. Praktika gjyqësore krijohet vetëm nga Gjykata Supreme e Kosovës. Në rastin konkret, Gjykata e Apelit nuk mund të pranoj si devijim nga praktika e saj e mëparshme vendimin e paditësve në raport me vendimin me të cilin paditësit sipas asaj lënde e kanë fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues në pronë shoqërore, sepse është e qartë për këtë gjykatë se i njëjti vendim nuk ka kaluar nëpër tri instancat konkretisht në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata e shkallës së parë edhe në këtë lëndë fillimisht e kishte aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve duke iu njohur të drejtën e pronësisë në pronë shoqërore me parashkrimin fitues, po thuajse në rrethana të njëjta faktike dhe juridike sikur në rastin në të cilin thirrën paditësit, mirëpo që i njëjti vendim është prishur dhe kthyer në rigjykim sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.1855/12 i datës 14.11.2014, ndërsa pas kthimit në rigjykim dhe rivendosje gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, e duke vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësve, që do të thotë se është vendosur ndryshe nga Gjykata Themelore, andaj edhe kjo nuk mund të pranohet si devijim nga praktika e saj e mëparshme në rrethana të ngjashme faktike dhe juridike, sepse gjykata e shkallës së parë nuk krijon praktika.*
42. Gjykata sa më sipër, sqaron se nëpërmjet Aktgjykimit të saj [KI49/20](#), të 20 janarit 2022, ajo nuk kishte rekomanduar ndryshimin e vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit, përkritazi me çështjet e fitimit të pronësisë nëpërmjet parashkrimit fitues, por riparimin dhe mënjanimin e shkeljeve procedurale të konstatuara nëpërmjet aktgjykimit në fjalë, për shkak se aktgjykimet paraprake të Gjykatës së Apelit nuk përmbushnin standardin e një vendimi të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor, në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNj-së, për faktin se Gjykata e Apelit nuk kishte adresuar dhe arsyetuar mjaftueshëm pretendimet relevante të parashtrueses së kërkesës në lidhje me trajtimin e barabartë para ligjit dhe konsistencën në vendimmarrje. Gjykata rikujton se ajo vetëm konstaton shkelje të të drejtave kushtetuese dhe nuk kërkon nga gjykatat e rregullta që të vendosin ndryshe për meritat

e një çështjeje, sepse nuk është tagër i saj për ta bërë. Kjo kompetencë edhe me tutje i takon gjykatave të rregullta.

43. Në këtë kontekst, Gjykata rithekson se nuk është detyra e saj që t'i zëvendësojë gjykatat e rregullta, që janë në pozitë më të mirë për t'i vlerësuar provat në dispozicionin e tyre, t'i konstatojnë faktet dhe interpretojnë të drejtën vendore (shih rastin e GjEDNj-së, [Khamidov kundër Rusisë](#), nr. 72118/01, Aktgjykim i 15 nëntorit 2007, paragrafi 170). Gjykata thekson se kur bëhet fjalë për konstatimin e fakteve dhe interpretimin e ligjit, është e "ndjeshme" për natyrën subsidiare të rolit të saj dhe se duhet të jetë e kujdesshme në marrjen e rolit të gjykatës së faktit, veçse kur një gjë e tillë është bërë e pashmangshme nga rrethanat e rastit (shih rastin e GjEDNj-së, [Bărbulescu kundër Rumanisë](#), nr. 61496/08, Aktgjykim i 2017, paragrafi 129).
44. Tutje, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit konkluzionet e saj i bazoi në qëndrimet parimore të Gjykatës Supreme, ku kjo e fundit kishte vendosur për çështje me natyrë të njëjtë ose të ngjashme faktike dhe juridike, duke arsyetuar se: "Sipas Ligjit Nr.06/L-054 për gjykata, tek kompetencat e Gjykatës Supreme, në nenin 26, par.1, nënpar.1.4, është paraparë që: "përcakton qëndrimet parimore, nxjerr mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës". Praktika gjyqësore indirekt paraqitet si një burim i të drejtës në rastet kur instancat më të larta gjyqësore, në një periudhë kohore më të gjatë në rastet e njëjta apo të ngjashme, sjellin vendime të njëjta. Për rastin e paditësve por edhe për rastet tjera që kanë të bëjnë me fitimin e pronësisë me parashkrim fitues në pronën shoqërore deri më tani nuk ka asnjë vendim të Gjykatës Supreme që është vendosur në favor të saj. Në përmbledhjen e Gjykatës Supreme në kontestet pronësore, Gjykata Supreme më aktgjykimin Rev.nr.106/2015 dhe aktgjykimin Rev.nr.344/2015 është shprehur në mënyrë të qartë se me parashkrim fitues nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë në pronën shoqërore, ndërsa për ndryshimet ligjore që janë bërë në vitin 1996 afati i parashkrimit për pronën shoqërore fillon të rrjedhë vetëm pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të vitit 1996, duke arsyetuar se ndryshimet e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore-Juridike, nuk kanë efekt retroaktiv, kështu që tek prej vitit 1996 e tutje, do të mund të llogaritët afati ligjor për parashkrimin fitues në sendet në pronësi shoqërore, mirëpo sipas kushteve të cilat i përcakton neni 28 i ligjit të cituar, për posedimin e ligjshëm dhe me mirëbesim. Përveç kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës është ajo që ka kompetencë ligjore që të përcakton qëndrimet parimore, nxjerr mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës e jo gjykatat e instancave më të ulëta.
45. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Aktgjykimit [[Rev. nr. 165/2022](#)] të 6 korrikut 2022 të Gjykatës Supreme, kjo e fundit në raste të ngjashme sikurse të parashtrueses së kërkesës, kishte arsyetuar se: "Pretendimet e revizionit që paditësi është në posedim të pa penguar të pronës së kërkuar dhe me këtë ka fituar pronësinë mbi bazën e parashkrimit fitues u refuzuan si të pabazuara. Lidhur me pretendimin revizionit se paditësi është një kohë të gjatë në posedim të pa penguar, Gjykata Supreme miraton qëndrimin e gjykatave më të ulëta dhe arsyetimin e dhënë në rastin konkret se çështja e posedimit nuk krijon raport pronësor e as të drejtë pronësie sepse në regjistrat kadastral figuron se prona është në pronësi të Komunës së Lipjanit. Në nenin 29 të LMTHPJ ka qenë e paraparë që "E drejta e pronësisë mbi sendet e paluajtshme, në pronësi shoqërore, nuk mund të fitohet mbi bazën e parashkrimit fitues". Me nenin 16 të Ligjit për ndryshimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (Fl.zyrt. e Jug. Nr.29/96) është shlyer kjo dispozitë ligjore, pra neni 29 i këtij Ligji dhe është lejuar fitimi i pronësisë me mbajtje nën kushtet e caktuara me ligj. [...]. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, norma ligjore bëhet për të rregulluar raportet juridike në të ardhmen, dhe nuk është parashikuar se kjo normë ka ndikim

*prapaveprues*". (shih rastin KI187/22, parashtrues *Elmi Mena*, Aktvendimi i 5 nëntorit 2024, paragrafi 62).

46. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktgjykimit të kontestuar [Ac. nr. 530/2016] të 30 marsit 2023, ka adresuar pretendimet thelbësore të parashtrueses së kërkesës, duke iu përgjigjur konkretisht çështjes që ndërlidhet me konsistencën në vendimmarrje për çështjet e fitimit të pronësisë me mirëbesim nëpërmjet parashkrimit fitues. Bazuar në këtë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Apelit në aktgjykimin e ri, ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm, gjithëpërfshirës dhe konkret përkitazi me pretendimin e ngritur për moskonsistencë në vendimmarrje e cila në rrethanat e parashtruese së kërkesës e ka konsumuar në vetvete edhe pretendimin e saj për trajtim të pabarabartë para ligjit, në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës, të cilat më parë nuk ishin shqyrtuar në mënyrën e duhur dhe në pajtueshmëri me të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor nga ana e Gjykatës së Apelit.
47. Për sa më sipër, në vlerësimin e pretendimeve që ndërlidhen me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së, Gjykata e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se "*drejtësia*" e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është drejtësi "*substanciale*", por drejtësi "*procedurale*". Në rrafshin praktik, koncepti i "*drejtësisë procedurale*" nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore/parimi i kontradiktoritetit procedural; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNj-së: [Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës](#), nr. 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese: [KI128/19](#), parashtrues *Artan Mala*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shkurtit 2021, paragrafi 58; dhe [KI22/19](#), parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
48. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se në rastin e parashtrueses së kërkesës janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura nga ana e Gjykatës së Apelit. Parashtruesja e i kërkesës edhe me tej mund të mos jetë e kënaqur me rezultatin e gjykimin të çështjes. Megjithatë pakënaqësia e saj nuk mund të ngrëjë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GjEDNj-së [Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë](#), nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
49. Gjykata dëshiron të rikujtojë gjithashtu se neni 31 i Kushtetutës dhe paragrafin 1 i nenit 6 të KEDNj-së, i obligojnë gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga ato të kërkohej përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih rastet e GjEDNj-së, [Van de Hurk kundër Holandës](#), cituar më lart; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 26).

## **Përfundim**

50. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se Gjykata e Apelit në Aktgjykimin [Ac. nr. 530/2016] të 30 marsit 2023: (i) ka dhënë bazën juridike dhe ka shpjeguar me qartësi se përse në rastin e parashtrueses së kërkesës nuk mund të pritej një rezultat ndryshe në lidhje me të drejtën e fitimit të pronësisë me parashkrim fitues; dhe (ii) se përse rastet e referuara nuk përbënin praktikë gjyqësore dhe burim të së drejtës në këtë kuptim. Për më tepër, aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit përmban lidhje logjike ndërmjet

bazës juridike, arsyetimit dhe përfundimeve të nxjerra, dhe si i tillë i përmbush kushtet e një vendimi të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor.

51. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se Aktgjykimi [Ac. nr. 530/2016] i 30 marsit 2023 i Gjykatës së Apelit është në përputhshmëri me kërkesat të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së.


### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur, më 5 nëntor 2024:

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri kërkesën të pranueshme për shqyrtim;
- II. TË KONSTATOJË, njëzëri se Aktgjykimi [Ac. nr. 530/2016] i 30 marsit 2023 i Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve, dhe në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë të njëjtin në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- IV. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

**Gjyqtari raportues**



Nexhmi Rexhepi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Gresa Caka-Nimani